



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/02-13424
Dt.25.09.2024.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	"SOLAR & ENGINEERING" SH.P.K me seli në Komunën e Graçanicës, në rrugën "Marin Barleti", e regjistruar me numër biznesi 811975583 dhe me pronar Kristë Duzhmani nga komuna e Graçanicës.		
Adresa:	Lagjja "Marigona Residence" – Preoc – Graçanicë.		
Telefoni:	048 544 980	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 32 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS të datës 15.07.2024, në objektin ekonomik ekzistues – qumështore në lokacionin "Brekoc", në ngastrën kadastrale me nr. 396/1, ZK: Brekoc.		
Emri i Projektuesit:	"SOLAR & ENGINEERING" SH.P.K. me numër biznesi 811975583		
Adresa:	Rrugën "Marin Barleti" – Graçanicë.		
Telefoni:	049 188 706	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: Rruga "Domenik Pergega".		
Zona(t) Kadastrale: Brekoc	Nr. i parcelave kadastrale: 396/1	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒

Përshkrimi: Lejohet Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 32 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS të datës 15.07.2024, në objektin ekonomik ekzistues – qumështore në lokacionin “Brekoc”, në ngastrën kadastrale me nr. 396/1, ZK: Brekoc.

Vërejtje: Obligohet pala që pas pranimit të Lejes Ndërtimore – Instalimit të paneleve të siguron pëlqimin nga ZRRE, dhe me të njëjtin të informon DUMM-në dhe KEDS.

Me këtë vendim, “SOLAR & ENGINEERING” SH.P.K me seli në Komunën e Graçanicës, në rrugën “Marin Barleti”, e regjistruar me numër biznesi 811975583 dhe me pronar Kristë Duzhmani nga komuna e Graçanicës, i lejohet Ndërtimi i sistemit solar, me kapacitet 32 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS të datës 15.07.2024, në objektin ekonomik ekzistues – qumështore në lokacionin “Brekoc”, në ngastrën kadastrale me nr. 396/1, ZK: Brekoc dhe njëkohësisht obligohet pala që pas pranimit të Lejes Ndërtimore – Instalimit të paneleve të siguron pëlqimin nga ZRRE, dhe me të njëjtin të informon DUMM-në dhe KEDS.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të vendosë tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha faza për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi – “SOLAR & ENGINEERING” SH.P.K me seli në Komunën e Graçanicës, në rrugën “Marin Barleti”, e regjistruar me numër biznesi 811975583 dhe me pronar Kristë Duzhmani nga komuna e Graçanicës, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-13424 të datës dt.26.08.2024 të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për Ndërtimin e sistemit solar, me kapacitet 32 kWp, konform Pëlqimit nga KEDS të datës 15.07.2024, në objektin ekonomik ekzistues – qumështore në lokacionin “Brekoc”, në ngastrën kadastrale me nr. 396/1, ZK: Brekoc.

DUMM, përkatësisht zyrtari përgjegjës për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 500 i vërtetuar nga DUMM, dt.23.09.2009.
- Kopjen e planit së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) në pronësi të PSH Komuna e Gjakovës të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Lejen Mjedisore komunale me nr, 07/351/02-14882, dt. 24.09.2024, lëshuar nga DUMM.
- Lejen Ndërtimore – Vendimi me nr. 07/351/01-71, dt.18.02.2010 lëshuar nga DUMM.
- Autorizimin nga Autorizimdhënësi Bekim Mirashi B.I. “Qumështorja ADA” për të Autorizuarin Kristë Duzhmani dt.24.06.2024.
- Marrëveshja për shfrytëzimin e tokës komunale në mes të shfrytëzuesit dhe Komunës së Gjakovës.
- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë.
- Pëlqimit Elektroenergjetik, nga KEDS të datës 15.07.2024.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga “SOLAR & ENGINEERING” SH.P.K me seli në Komunën e Graçanicës.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim.

Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t’i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

Hartoi aktin

Zenel Shabani Z.L. Ligjor

Zyrtari përgjegjës për lëndë

Durrije Berisha I.D.A.

Drejtori

Arben Bakalli